



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT, PJESËTARE E KOALICIONIT "SHPRESA PËR NDRYSHIM", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për pranimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Korçë, Tiranë, të paraqitura nga Partia Bashkimi Liberal Demokrat pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Bashkimi Liberal Demokrat , si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia Bashkimi Liberal Demokrat, me vendimin e KQZ-së nr. 170, datë 16.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 7.05.2019, është regjistruar koalicioni "Shpresa për Ndryshim", pjesë e të cilit është dhe Partia Bashkimi Liberal Demokrat.



**Nr. 630 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Bashkimi Liberal Demokrat", pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Korçë, Tiranë.

KQZ, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkive:

- Korçë me vendimin nr. 495 datë 17.05.2019.

Brenda afatit Partia Bashkimi Liberal Demokrat, ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimit të KQZ-së për Bashkinë Korçë.

Partia Bashkimi Liberal Demokrat nuk ka depozituar në KQZ 18 nga 31 formularë vetëdeklarimi për Këshillin e Bashkisë Tiranë. Referuar nenit 5, pika 2, parashikohet se, "Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 73, pika 2, duhet të refuzojë listat e kandidatëve për Këshillin e Bashkisë Tiranë të Partisë Bashkimi Liberal Demokrat.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetarë apo për këshillin e bashkisë: Korçë; pasi bashkia Korçë, administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Korçë;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtarë këshilli në Këshillin e Bashkisë Korçë, të propozuar nga Partia Bashkimi Liberal Demokrat;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetimet e Kuvendit të Shqipërisë, për zotërimin e 6 mandateve të z.Koçi Tahiri, znj.Elda Hoti, znj.Majlinda Halilaj, z.Zef Shtjefni, z.Kostaq Papa, z.Adriatik Alimadhi, dorëzuar me shkresën përcjellëse me nr. 4031 prot, datë 20.05.2019 sipas të cilit vërtetohet se koalicioni zotëron 6 mandate në Kuvend sa numri i partive pjesëmarrëse;
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit;

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Korçë, të Partisë Bashkimi Liberal Demokrat dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" përveç se:

### **1. Shpendi Skender Dragolli, kandidat për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Korçë:**

- Në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit (A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj), i është përgjigjur me (Po) duke deklaruar se:



- me vendimin nr. 331 datë 09.11.2007, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, për veprën penale të parashikuar nga neni 273 K.P "Largim nga vendi i aksidentit", ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 4 muaj e 10 ditë burgim;
- **Në pikën 4** të formularit të vetëdeklarimit (A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale), i është përgjigjur me (Po) duke deklaruar se:
  - Është ndaluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë datë 26.06.2007 për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i K.P e cila ka kaluar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
- **Në pikën 5** të formularit të vetëdeklarimit (A është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo), i është përgjigjur me (Po) duke deklaruar se:
  - është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, për kundravajtje penale, për veprën penale parashikuar nga 273 K.P, është dhënë vendimi përfundimtar nr.331 në datë 09.11.2007. (arrest në shtëpi)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezulton se:

#### **Lista shumemërore e Bashkisë Korçë:**

1. Kandidati me numër **rendor 1, z. Shpendi Skender Dragolli** në bazë të vendimit nr .331, Dt. 09.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Korçë është deklaruar fajtor për veprën penale të "Largimit nga vendi i aksidentit", parashikuar nga neni 273 i K.P dhe në aplikim të nenit 406 te K.Pr.P është dënuar përfundimisht me 4 muaj e 10 ditë burgim. Rehabilituar në bazë te nenit 69 te Kodit Penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



## V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin Bashkisë Korçë, të Partisë Bashkimi Liberal Demokrat pjesëtare të Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Refuzimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Tiranë të Partisë Bashkimi Liberal Demokrat pjesëtare të Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

